

BIBLIOTEKA
SHTETIT

BIBLIOTEKA E NXENËSIT

3988
K S!



KËNGË POPULLORE LEGJENDARE

SHTËPIA BOTUESE E LIBRIT SHKOLLOR
TIRANË, 1975

39
KSL

BIBLIOTEKA E NXËNËSIT

KËNGË POPULLORE
LEGJENDARE

Për nxënësit

e shkollave të mesme



SHTËPIA BOTUESE E LIBRIT SHKOLLOR
TIRANË, 1975

Mbledhur e pajisur me shënimë nga
Tarik Llagami

Ky botim për shkollat e mesme përmban disa pjesë të zgjedhura nga epika janë legjendare.

Qëllimi i kësaj përbledhjeje është që t'i pajisë nxënësit me njohuri më të gjëra rreth këtyre këngëve kaq të bukura e plot me mendime, t'i bëjë ato që t'i përvetësojnë më mirë këto vlera dhe njëkohësisht të zërthejnë kuptimin që kanë në lidhje me kohën kur kanë dalë. Në këtë përbledhje janë përfshirë disa nga këngët legjendare që është menduar se janë më të përshtatshme për nxënësit e shkollave të mesme. Me qëllim që të bëhen sa më të përdoroshme nga nxënësit, janë dhënë disa njoftime mbi përbajtjen dhe idetë kryesore të qdo pjese, janë dhënë shpjegime fjalësh të vësh-tira. Tek-tuk është bërë ndonjë shkurtim, ndreqje trajtash tepër nëndialektore dhe së fundi në dob; të një përvetësimi sa më aktiv është ndërtuar një aparat i thjeshtë pedagogjik me pyetje e detyra të shku:tra.

Tirazhi: 5000 kopje Formati: 70 x 100/32 Stash. 2204-72

Shtypur: Drejtoria Qendrore e Poligrafisë
Shtypshkronja «MIHAL DURI» — Tiranë

KËNGË LEGJENDARE

MURIMI NË KALA

(Shkodër)

Legjenda e murimit është një nga më të vjetrat e më të përhapurat e folklorit tonë. Në themel të legjendës është ideja e sakrificës apo fljimit. Legjenda përmban edhe shumë ide të tjera të rëndësishme. Ajo vë në dukje pozitën e nënshtuar të gruas që sakrifikohet. Legjenda dënon tradhëtinë e dy vëllezërve të mëdhenj që çlidhin besën dhe miraton qëndrimin e ndershëm të vëllait të vogël. Të bën përshtypje sidomos dashuria e nënës për fëmijën, kjo shprehet në amanetin e bukur që ajo lë në çastin e murosjes.

I ra mjegulla Bunës,
ndej tri dit e ndej tri net;
mbas tri ditsh e mbas tri netsh,
fryni nji freski e hollë,
5 e naltoi-o mjegullën,
e naltoi der n'Valdanuz,¹
ku punojschin tre vëllazën...
Gjithë ditën po punojnë,
gjithë natën po u rrënohet!
10 Shkon nji plak-o² aty pari:
— Puna mbarë, o tre vëllazën!

1) kështjellë, vend afër 2) njeri i ditur, me përvojë Ulqinit.

— Të mbarë paç, o plak i gjallë!
 Ku po e shef të mbarën tonë?
 Ne gjith' ditën po punojmë
 15 e gjith' natën na rrënohet.
 Amanet, o plak i gjallë,
 a din gja me na kallzue?
 — Un' e di, por kam gjynah...³
 20 A jeni të tre t'martuem?
 A i keni të tre ju vashat?⁴
 — Po, të tre t'martuem jena
 e të tre vashat i kena;
 na dëfto pra çka me ba,
 si me e ngrehun kët' kala!
 25 — N'daçi drejt ju me punue,...
 në konak⁵ mos bisedoni,
 vashave mos u kallzoni!
 Nesër nadje⁶, t'zbardhmen drita,
 cila vashë t'ju bjerë bukën,
 30 at muronie n'mur t'kalasë.
 E at'herë keni me pa,
 se kalaja vend ka zanë.
 Vaj!⁷ Ai ma i madhi vlla,...
 në konak e bisedoi,
 35 vashës s'vet edhe i kallzoi.
 Ashtu bani i dyti vlla:
 harroi kskillën, që i pat vu,
 plaku i gjallë që i kish dëftue,...
 në konak e bisedoi,
 40 vashës s'vet edhe i kallzoi.
 Por ai ma i vogli e ma i miri, ...

3) më vjen keq

6) në agim-

4) gratë

7) sa keq!

5) shtëpi

në konak s'e bisedoi,
 vashës s'vet nuk i kallzoi.
 Çohen n'nadje herët-o;
 45 gurët po coptohen-e,
 zemrat-o po rrähin-e!
 Thurret nana gjelinat-e⁸:
 — Gjelinë, e madhja gjelinë,
 ustallarët duen bukë,
 50 duen bukë e duen ujë!
 — Besa, nanë, atje s'po vete,
 se kam ndjehun⁹ sot e ligë¹⁰.
 — Gjelinë, e dyta gjelinë,
 ustallarët duen bukë,
 55 duen bukë e duen ujë...
 — Besa, nanë, atje s'po vete,
 sot do t'shkoj n'gjini¹¹ e shkreta.
 — Gjelinë, e treta gjelinë!
 — Lepe¹² nanë, e zoja¹³ nanë,
 60 — Ustallarët duen bukë,
 duen bukë e duen ujë...
 — Besa, nanë, atje po vete,
 por kam djalin t'vogël-o.
 — Nis e shko, gjelina ime,
 65 se ne djalin ta shikojmë
 e s'e lamë të vajtojë.
 Mori bukë e mori ujë, ...
 ra te poshtë nëpër Kazenë,¹⁴
 iu afriue murit t'kalasë.

8) gratë, nuset

13) e mirë, e dashur, e

9) gdhirë

nderuar

10) e sëmurë

14) Emër i një lagjeje të

11) njerëzit e familjes së
nuses

vjetër në të djathët të
Bunës (Shkodër)

12) urdhëro!

- 70 Çekiçët po ndalen-e,
zemrat-o s'po rrahin-e,
ftyrat-o po teren-e.¹⁵
Kur e pa i shoqi i saj:...
— Paska qenë rrezik për ty,
75 ne në mur-o me të shti!
— Shëndoshë ju, o kuneti¹⁶!
Nji amanet po ju la:
Kur në mur-o t'më muroni,
syn e djathjtë t'ma leni jashtë,
80 dorn e djathjtë t'ma leni jashtë,
kambn e djathjtë t'ma leni jashtë,
gjin' e djathjtë t'ma leni jashtë;
se kam lanë djalin të vogël
e kur t'nisi djali gjamën,¹⁷
85 me njan' sy ta shikoj,
me njan' dorë ta lëmoj,
me njan' kambë ta lurtoj,¹⁸
me njan' gji ta närgoj,¹⁹
Gjini im u nguroftë²⁰
90 e kalaja u forcoftë!...

15) zverdhen

16) Në vend të numrit shumës kunetër përdoret emri *kuneti*.

17) vajtimin, të qarët

18) përkëdhel

19) ap të pi, ushqej

20) u bëftë gur!

— Vini në dukje ç'do të japë rapsodi me mjegullën.

— Vini re sa shpejt e me lehtesi e krijon ai peisazhin; gjeni vargjet që e krijojnë atë.

— Krahasoni përgjigjet e dy nuseve të para dhe tregoni ç'karakter fshihet pas tyre.

— Karakterizoni figurën e nuses së tretë. Ilustroni me vargjet përkatëse botën e saj të brendshme si nënë.

— Argumentoni përsë ekzistonin në të kaluarën flujimet dhe shpjegoni kotësinë e tyre.

KËNGA E DHOQINËS

(Hoshtevë — Zagori)

Kjo këngë legjendare është ndër më të njohurat e folklorit tonë. Ajo gjendet në disa variante të përafërtë me njëra-tjetrën. Ideja themelore që e përshkon është mbajtja e besës së dhënë. Dhoqina, motra e vetme e nëntë vëllezërve, është martuar larg me këmbënguljen e vëllait të vogël, Kostandinit. Rrjedha e qetë e jetës së kësaj familjeje ndërpritet: njëri pas tjetrit vdesin të gjithë djemtë, nuset dhe fëmijtë e tyre. Nëna mbetet e vetme. Ajo kërkon të çmallet me të bijën. Kostandini sa qe gjallë i kishte dhënë besën së emës se do t'ia sillte vajzën sa herë që ajo ta donte. Për të mbajtur fjalën ai «ngrihet» nga varri, shkon e merr të motrën, ia sjell së emës. Po edhe ato nuk e gëzojnë njëra-tjetrën, se pa u takuar akoma «plasën si qelqi me verë». Kjo baladë është e mbushur me elemente fantastike, po ideali i besnikërisë e përshkon nga fillimi në fund. Gjithçka përfundon me fatkeqësi, po mbi fatkeqësitë, vdekjet, këngëtarë popullor ka treguar se asgjë nuk duhet ta pengojë njeriun kur është puna për të mbajtur fjalën e dhënë.

Ditën e pashkës në drekë
se ç'u ther një ka në fshat;
vajta e mora një okë¹ mish
dhe e hodha në kusi,
5 me vrapi dola në avlli²,

1) masë peshe afërsisht
1,5 kg

2) muri rrethues i shtëpisë

të marr një kërcu të zi,
 Të më shpiket³ një stëhi,⁴
 me vrap m'u hodh në kusi,
 më helmoi djemt' e mi,
 10 nëntë djem e nëntë nuse,
 të nënta me djem në duar.
 Nëntë djepë ç'm'i përbmbysë,
 nëntë pajë ç'm'i zhurite,
 nëntë dyfekë ç'm'i shite.
 15 Kostandin, të ardhtë gjëma,⁵
 martove Dhoqinën larg,
 larg e larg mërguar,
 tre male kaptuar!
 Ditën e pashkës së madhe,
 20 Dhoqina na hidhej valle,
 Kostandini u ngrit nga varri,
 rrasha⁶ iu bë kalë,
 balta iu bë shalë,
 vrap e vrap e te Dhoqina:
 25 — Mirserdhe, o im vëlla!
 Në ke ardhur pér të mirë,
 të vishem si gjeraqinë,⁷
 në ke ardhur pér të keq,
 të vishem si kallogre.⁸
 30 — Jo, motër, sikundër je.
 I hipi në vithe kalit.
 Zogjtë udhës thoshin:

3) shfaqet

4) Qenie mitologjike, që u
- bën të këqija të mëdha
njerëzve. Nganjëherë
përfytyrohet në trajtën
e gjarprit.

5) lajmi i keq, mandata

6) guri i varrit

7) grua e shpejtë dhe e
shkathët; këtu: të vi-
shem bukur

8) grua e mjerë, e veshur
me të zeza

— Ciliviu, viu, viu,
 kush ia bën ia bën vetiu,
 35 keni par' e s'keni parë,
 shkon një zogëz bishtbardhë,
 i vdekuri me të gjallë. —
 Vete gjer tek der' e kishës;
 — Ik, moj Dhoqinë,
 40 se kam punë n'ajodhimë ⁹,
 se aty e kam shtëpinë.
 Vajti gjer tek dera,
 çëk, çëk në portë.
 — Ç'je ti që kërcet në portë?
 45 Mos je bushtër ¹⁰ a mos je murtajë, ¹¹
 a mos je zonja ¹² murtajë,
 që më hëngre djemt' e mi?
 — Hap moj nënë derën,
 jam Dhoqin' e vetëm!
 50 — Me cin, erdhe, moj Dhoqinë?
 — Unë ardhsh me Kostandinë,
 — Ç'Kostandin moj t'ardhëtë gjëma!
 Kostandini i vdekur,
 ç'bën tre vjet pa tretur?
 55 — Një në prak e një në derë,
 plasën si qelqe ¹³ me verë.

9) një vend i caktuar në
kishë

10) grua e ligë

11) sëmundje e rëndë, ngji-
tëse dhe epidemike

12) këtu është përdorur për
efekt zbutës, për ta
marrë me të mirë

13) shishe

— Ç'qëndrim mban nëna plakë përpara fatkeqësive që i
kanë ndodhur. Përshkruani gjendjen shpirtërore të saj.
 — Ç'elemente fantastike janë përdorur në këtë këngë?
 — Gjeni krahasimet e përdorura në këtë baladë.

KËNGA E YMER AGOS

(Nivan — Zagori)

«Kënga e Ymer Agos» është një nga ato balada legjendare që flet për rinjohjen e burrit me gruan. Balada hedh dritë mbi ato kohë të rënda e plot mjerime kur burrat qenë të detyruar të braktisnin nënrat, nuset e sapomarra, familjet dhe të vraponin në luftëra ku i detyronin paria dhe pushtuesit, apo nëpër dhera të huaja për të siguruar një kothere bukë. Këto ndarje shkaktonin fatkeqësi të shumta familjare. Pjesa më e madhe e këtyre burrave nuk kthehet e gjallë, ose edhe kur kthehet e gjenin familjen të shkretuar, nënën të vdekur, nusen të mjeruar a të martuar gjetkë. Edhe kjo balladë pëershkohet nga besnikëria midis bashkëshortëve. Në mënyrë të dukshme spikat besnikëria e gruas, të cilën könga e vlerëson shumë.

Psherëtiti Ymer Agai,*
luajti gjithë sarai,¹
dëgjoi brenda pashai:
— Vallë ç'pati Ymer Agai,
5 që lojti gjithë sarai?
As ha buk' e as pi verë,

* Pushtimi turk në vendin tonë ka ndikuar në disa elemente të gjuhës së këtyre këngëve. Kjo duket

në futjen e fjaleve: aga, pasha, imanë etj.
1) ndërtësë e madhe, kullë, pallat

t'englediç² karadyzenë?³
— As buka më hahet,
as vera më pihet;
10 pashë një ëndërr sonte,
sikur m'u martua vasha
e ma mori Ali Pasha.
— C'amane⁴ më lë këtunë?
— Të lë besën e imanë,⁵
15 për tri ditë të vij prapë.
— Trima, stolisni karanë,⁶
të përcillni Ymer Aganë!
Rashë kalit, ik' e ikë,
në fund të baçes u gdhiçë:
20 — Mirëdita, e moj nënë!
— Mirse erdhe, o rob i zënë!
— Pse prish, moj nënë, baçenë?
— Djali iku e m'u harrua,
nusja sonte m'u martua.
25 — A kanë herë që shkuan?
— Sa bregnë kapëtuan.⁷
një dyfek lëshuan.
Rashë kalit, ik' e ikë:
30 — Daleni, o krushq bujarë,
t'më jepni një herë verë
e t'ju darovit⁸ nusenë.
O moj vashëza mbi kalë,
a njohe shortin⁹ e parë?
— Ku ta njoh e zeza unë?

2) të kalosh kohën

3) vegël muzikore me dy

tela, çifteli

4) peng, dorëzanës

5) besimin; këtu: besën

6) kalë i zi

7) kapërcyen, kaluan

8) t'i dhuroj diçka, t'i ap
ndonjë gjë

9) fatin; këtu: burrin

- 35 Një natë të fjetur,
një nishan në vetull,
dhe një nënë sqetull.
T'u bëfsha kurban i ballit;
merrm' e hidhmë vithe kalit!
- 40 Udh' e mbarë, o krushq bujarë,
se njoha shortin e parë.
Falni me shëndet pasheshës,¹⁰
e hatëri mos t'i jesë,¹¹
pa i jap një time mbesë.

10) gruas së pashait

11) mbetet

— Përshkruani gjendjen e heroit të këngës si rob lufte.
Vini në dukje se sa e rëndë ishte për popullin tonë kjo plagë.
Ilustrojeni mendimin tuaj me vargjet përkatëse.

— Cfarë mendimi shprehet përmes vargjeve të bisedës
së nënës me djalin.

— Gjeni hiperbolat në këtë këngë.

GJON PRETIKA

(Shestan — Krajë)

Në këngët e rinojohjes së vëllait me motrën bën pjesë edhe balada «Gjon Pretika». Këngën e përshkon ideja se pushtimi i huaj, veç të këqijave të tjera, i kishte sjellë popullit fatkeqësi të mëdha familjare. Njerëzit e një gjaku ndaheshin qysh për së gjalli dhe qëndronin vite të tëra larg e pa asnje lajm prej njeri-tjetrit.

Këtu si shenjë njohjeje për motrën dhe vëllain shërbejnë gjashtë gishtërinjtë që ka Gjoni, si në një dorë, ashtu edhe në një këmbë.

Legjenda portretizon në mënyrë të veçantë vajzen. Bukuria e zërit dhe e këngës së saj mahnit gjithë ushtrinë armike. Të prek thellë çasti kur që të dy të rinjtë, vëlla e motër, të përqafuar plot mall, «plasën tue qa». Një fund i tillë tragjik, që e gjejmë edhe tek «Gjergj Elez Alia», «Kënga e Dho-qinës» etj. është element që haset jo rrallë në folklorin tonë legjendar. Mallin dhe dashurinë e zjarrtë midis vëllait dhe motrës rapsodi e përjetëson duke krijuar pas vdekjes së tyre një mjedis të lëzuar pranveror.

Këndon blega¹ zanë² në mal,
mendon se s'po ndien kush.
Gjith ushtria po e ndëgjon.

1) vajza

2) zana përfytyrohet si një vashë e bukur dhe lufta-

rake që u vjen në ndihmë trimave

- Sa mirë blega po këndon!
- 5 — Kush asht trim e kush asht djalë,
për me e zanë blegën në mal?
Gjon Pretika, trim i mirë,
ndodhi trim e ndodhi djalë,
ai dhe e zu blegën në mal;
- 10 pér flokësh po e hjek rrqanë.³
— Mos hiq, trim, o i paganë!⁴
se nuk jam unë e shkretë,
por e kam nji tim vëlla!
— Ku e ke, he mos e paç!
- 15 — Mos ma nem,⁵ goja t'u thaftë!
Në ushtri e kam diku.
— Emnit-o si t'ia thonë?
— Emnit m'ia thonë Gjon.
Ai ka shenja pér t'u njohtë:
- 20 gjashtë gishta në nji dorë
edhe gjashtë në nji kambë.
— A ti je, Fasile, motër?
— Unë, jam, o Gjon, vëlla!
Edhe u kapén grykamgrykë,
- 25 porsi motra me vëlla.
Të dy plasën tue qa.
Ku ra Gjoni, bini ftoni;
aty çeli luleftoni.
Ku ra blega, bini shega;
- 30 aty çeli luleshega.

3) têrheq, zvarrë, rrëshqa-
në

4) i pafe

5) mallko

- Karakterizioni figurën e vajzës shqiptare duke theksuar qëndrimin e saj të vendosur ndaj pushtuesit.
— Gjeni figurat letrare që janë përdorur në këtë këngë.
— Cili shkrimitar i Rilindjes sonë kombëtare e ka shtjetluar këtë motiv balade në një vjershë të tij? Me ç'qëllim?

PARASTEN KONTESHA KONTË¹

(I tha kontesha konttit)

(Arbëreshët e Italisë)

Sadoqë nëpërmjet elementeve fantastike e legjendare në këtë krijim gjemjë një ide shumë të rëndësishme. Populli përherë është ndeshur dhe ka fituar mbi forcat e panjohura të natyrës. Këto forca janë përfytyruar në fantazinë e poetit popullor me kuçedrën. Ndeshjen midis njeriut dhe forcave të errëta të natyrës kënga e jep si një luftë të ash-për midis dëshirës së egër të kuçedrës dhe dënimit që ajo pëson nga trimëria e njeriut. Këngën e përshkon kështu besimi te njeriu, te mençuria dhe guximi njerëzor. Me vlerë shumë të madhe është në këtë këngë fakti se në shkatërrimin e kuçedrës merr pjesë dhe luan rolin themelor një grua që jipet nga poeti popullor si «vetim' e qiejve» që djeg e shkatërron ligësitë.

I tha kontesha konttit: ²

— O ti biri im kont,
gjithë maleve ti gjuaj,
veç në mal t'kuçedrës jo,

-
- 1) Kjo baladë e arbëreshëve të Italisë është dhënë këtu me gjuhën tonë të sotme.
 - 2) titull fisnikërie i përdo-

rur në feudalizëm. Kënga quan kështu nënën dhe të birin për t'i çmuar më shumë.

- 5 se del kuçedra e tē ha,
 tē ha ty e tē pērpin.
 Trimi s'e dēgjoi t'ämén,
 po dēgjoi tē bukurēn:³
 — N'asnjë mal ti, trim, mos gjuaj,
 10 veç nē mal t'kuçedrēs gjuaj.
 Pasi hyri ai te mali,
 doli kuçedra ta hajë.
 Djali i trembur iu lut:
 — O kuçedér e stérkuçedér,
 15 lermë tē vete te mëma ime,
 t'i kérkoj uratën.⁴
 — Näm ti besën, pastaj ec.
 Shkoi me vrap te e äma:
 — O ti, mémë, o mëma ime,
 20 näm uratën e vdekjes.
 E äma i dha uratën.
 Gjeti edhe tē bukurēn:
 — Lamtumirë, o zonja ime,
 se po shkoj e s'shihemë më.
 25 — Dua tē vij edhe unë me ty.
 Ajo i hipi një kali tē bardhë,
 trimi i hipi një kali tē zi,
 shkuan te mali kuçedrēs.
 Sa i pa nga larg kuçedra,
 30 zuri tē gëzohej.
 — Lumja unë e lumja,
 kisha një e i bëra dy!
 — Mjera ti, kuçedér e mjerë,
 kishe një e s'ke asnjë!
-

3) tē dashurēn, që këtu
është paraqitur me veti
tē mbinatyryshme.

4) këtu: tē më falë gabimet që kam bërë ndaj
saj

- 35 foli vasha e u afruan.
E ngriu⁵ vajza e lidhi në vend!
— Nga ç'gjiri⁶ je ti vajzë?
— Jam e bija e hënës,
kam për babë diellin,
- 40 vetë jam vetim' e qiejve,
që bie maleve,
maleve e fushave
mbi kreninë e ligësisë.
— Vajzë mbi vajzat e dheut,
- 45 shkofsh ti mirë e me shëndet,
trashëgofsh ti trimin tënd!
- C'mendim dëshiron të shprehë këngëtarit popullor përmes veprimeve të vajzës?
— A dini ju krijime të tjera popullore ku të flitet përluftën e së mirës kundër së keqes?

5) e la pa frymë, e ngurosi

6) gjini, fis.

39986
LIBRERIA E SH. TITI
G. DODA & H. 17
INN. 67386

LARG MA LIVDOJSHIN NJI VASHË

(Oblikë — An' e malit)

Subjekti i kësaj këngë legjendare është thurur duke treguar dëshirën dhe përpjekjet e një djali të ri për të rrëmbyer një vajzë të mirë e të bukur që e lavdëronin gjithë botë. Largësia deri «andej detit» s'e pengon atë që të arrijë këtë pikësynim.

Balada, përmes pëershkrimeve të lehta e të shpejta na njeh me jetën mesjetare. Gratë, të mbyllura nëpër shtëpitë, pa asnjë liri e të drejtë shoqërore, dalin të blejnë vetëm nëpër dritare, me fytyra të mbuluara prej «kaftanësh». Gjendja e nënshtruar e femrës plotësohet në fund të këngës: vasha, që aso kohe shitej e blihej si plaçkë tregu, bille edhe mund të rrëmbehej, përfundon në duart e djalit. Mbyllja e këngës krijon një kontrast të dhembshëm, me të cilin kuptojmë qëndrimin e papjtueshëm të popullit ndaj asaj shfaqjeje të shëmtuar të jetës së atëherëshme.

Larg ma livdojshin¹ nji vashë,
larg e larg e andej detit.

Ma livdojshin, besë s'i zuna,
deri vojta e rash e e pasë.²

5 Ma e mirë ish se ma livdojshin;
porse ishte pak e vogël.

— Mso,³ moj nanë, si ta marr!

1) lavdëronin
2) shkova ta shikoj

3) më mëso

— Un' tē msoj, o djali im:
 mbush nji barkë nizamë⁴ tē rinj,
 10 shtjer tri palë lodërti,⁵
 mbushe plot me reshperi,⁶
 shtjer mëndafsh e bugasi;⁷
 bjeri detit, dil andej!
 Kur t'avitesh në qytet,
 15 ata e kanë nji adet:⁸
 dalin gratë penxhereve.⁹
 Ma e para që tē dalë,
 ajo me kaftan¹⁰ tē murgët,¹¹
 mos kujto se¹² vasha jote,
 20 ajo, djalë, a¹³ vjehrra jote.
 Ma e dyta që tē dalë,
 ajo me kaftan jeshil,
 mos kujto se vasha jote,
 ajo, djalë, kunata jote.
 25 Ma e treta që tē dalë,
 ajo me kaftan me ar,
 kujto mirë se vasha jote.
 — Ulu vashë e zgjidh mëndafsh!
 — S'kam nevoj-o pér mëndafsh,
 30 se e kam babën kazas.¹⁴
 — N'daç mëndafsh, n'daç bugasi.
 — S'kam nevojë pér bugasi,

4) ushtarë

5) lodra, curle e mjete tē
tjera muzikore popullore;
orkestër popullore

6) sende tregtie

7) një lloj stofi i mëndaf-
shtë, që përdorej pér tē
bërë veshje tē kushtue-
shme pér gra

8) zakon

9) dritarevet

10) kadife

11) tē errët, tē zi

12) mungon folja *është*

13) *është*

14) Ata që tirrin dhe end-
nin mëndafsh, pam-
buk, li etj.

se kam babën dugajxhi.¹⁵
Vasha tuvej¹⁶ ulun-o,
35 barka tuj përkulun-o;
vasha tuvej zgjedh mëndafsh,
barka hidhet pash më pash.
Vasha synin plot me lot,
djali zemërën pëlot.¹⁷

15) dyqanxhi
16) duke

17) plot

— *Tregoni për jetën e mbyllur të vajzave në të kaluarën. Ilustrojeni këtë edhe me vargjet përkatëse të këngës.*

NGA CIKLI I KRESHNIKËVE

FUQIA E MUJIT

(Curraj i Epër)

Kënga «Fuqia e Mujit» mund të kuptohet edhe si një hyrje në Ciklin e Kreshnikëve. Në të bëhet fjalë për kthimin e Mujit nga një bari i varfër e «keqot» në një hero vigan. Zanat e malit vlerësojnë lart virtyet e tij, kur Muji u pushon vajin fëmijëve të tyre në shpellë. Prandaj ato, si shpërblim, i plotësojnë kërkesën për ta pajisur me forcë, duke e mëndur me qumësh gjiri. Muji fiton një fuqi fizike të jashtëzakonshme, sa të ngrejë shkëmbin 1000 okësh. Kështu që me të s'mund të hahet më askush për forcë. Paskëtaj atë do ta shikojmë të kryejë bëma trimërore vetëm ose me shokë.

Legjenda e fut dëgjuesin në një ambient fantastik.

Portretin e Mujit me përmasa të mbinaturshme rapsodi e ka dhënë në lidhje me dëshirën e heroit për të punuar dhe për të qenë i thjeshtë në jetë.

Eshtë me rëndësi të theksohet se Muji paraqitet si bir i vegjelisë, bari lopësh, njeri i këputur ekonomikisht. Midis gjithë të mirave që i afrohen, ai zgjedh forcën «me qindrue». Kjo në vetvete përmban një të vërtetë reale, historike: shqiptari, për t'u rezistuar stuhive të jetës, ka dashur të jetë gjithmonë i fortë e i pathyeshëm. Legjenda hedh drithë gjithash tu mbi shfrytëzimin e njeriut nga njeriu, i njerëzve të thjeshtë e pa gjë të gjallë prej atyre që janë të pajisur me prona të shumta.

... Kur kish qenë Muji djalë i ri,
ma kish çue baba n'rrogë te nji zotni.
Çoban lopësh zotnia e ka ba.
Për gjithë ditë bjeshkët Muji tuj i kërkue,
5 pér gjithë ditë ndër gurra tu u freskue
pér gjithë ditë ndër mriza¹ tuj pushue.
Rrugë as shteg pa njohtë nuk ka lanë,
m'i çon lopët gjithherë ku s'in kanë.²
Nji natë lopët çobanit i paskan humb
10 e te shpia nuk ka mujtë me dredhë;³
buzë nji shkambi me u ndalë asht ngushtue,⁴
asht ulë djali aty pér me fjetë;
paj,⁵ dy djepa aty kin qëllue
e kanë marrë britmën e tuj kajtë.⁶
15 M'asht avitë Muji me i shikue,
m'asht avitë Muji me i pajtue,⁷
po i pajton tuj i përkundë
e t'dy djepat i ka vu në gjumë.
Bardhë si drita dy zana atherë kanë ardhë.
20 — Ty qysh të thonë? — Mujin e kanë pyet.
Kqyre Muji at'herë çka u ka thanë:
— Rrogtar lopësh un' kam qëllue,
pér gjithë ditë kto bjeshkë i kam kërkue,
mue rreziku sot ka ardhë me më ndeshë:
25 m'kanë hupë lopët e askund s'kam mujt me i
gjetë;
ktu m'zu nata e u ula pér me fjetë,

-
- 1) vende nën lisa të më-
dhenj, ku pushojnë ba-
gëtitë verës.
2) ishin kanë. Në Malësi të
Veriut përdoret në vend
të: kishin qenë.

- 3) të kthehej
4) detyruar
5) por
6) duke qarë
7) pér t'i qetësuar, pér t'i
pushuar

- s'mbylla sy prej vajit, që kam ndie,
 kishin qenë tuj kajtë këta dy fmi;
 kurrkund çajre⁸ fmija nuk m'kanë lanë,
 30 m'u kanë dhimtë e jam hullë⁹ me i pajtue,
 i pajtova e sa grima¹⁰ n'gjumë i kam vu.
 — Po çka jeni ju me gjithë kët' dritë?
 — Zana jemi, Mujo, tuj shetitë,
 tuj u sjellë¹¹ ne njerzve me u ndihmues;
 35 ti çfarë nderi, Mujo, po na lypë,
 që dy djepat na i ke vu në gjumë?
 A don forcë, Mujo, me qëndrue,
 a don luftë, Mujo, me luftue?
 A don gja, Mujo, a don mall,
 40 a don dije, Mujo, a don gjuhë?
 Lyp çka të duesh! Mujit i kanë thanë.
 Kqyr Muji at'herë ç'ka qitë e ka thanë:
 — Shpesh po më ngucin¹² çobania,¹³
 shum inat çobajt si më kanë,
 45 paj, me forcë me ua kalue un' due.
 Njana shoqes zanat at'herë i kanë thanë:
 — Tamël¹⁴ gjiut Mujit për me i dhanë.
 Tamël gjiut i kanë dhanë me pi,
 me tri pika djalin ma kanë ngi...
 50 — Kape gurin! zanat i kanë thanë.
 Nji mijë okësh e ma guri ish kanë.
 E ka kapë gurin nji mijë okësh,
 badihava¹⁵ peshue me duer e ka;
-

8) këtu: qetësi, pushim

12) ngacmojnë

9) u hodha, shkova

13) barijtë

10) shpejt e shpejt

14) qumësht

11) duke u sjellë, duke lë-
vizur lart e poshtë

15) me lehtiësi

- deri në nyje t'kambës e nuk mujt ma.
- 55 Njana shoqes zanat at'herë i kanë thanë:
 — Edhe do¹⁶ tamël Mujit me ia dhanë.
 E ka marrë tamlin Muji e e ka pi,
 e ka kapë gurin me e peshue,
 deri në gju ai gurin e ka çue;
- 60 e ka ulë prap n'tokë e ka pushue.
 Kqyre zana sa mirë ka thanë:
 — Edhe pak gji Mujit me ia dhanë ...
 E e ka marrë gurin me e peshue,
 deri në shogë¹⁷ gurin e ka çue.
- 65 E kanë pa zanat, e kanë kqyrë,
 njana-tjetrës prap tek i kanë thanë:
 — Opet¹⁸ Mujit gji lypet me i dhanë.
 E ka marrë Muji gji me pi ...
 Qenka ba si me qenë drague!¹⁹
- 70 Ka marrë gurin me e peshue,
 n'cep të krahut e ka vue,
 nji mijë okësh guri i ka qëndrue.
 Njana shoqes zana çka i ka thanë:
 — Tjetër gji Mujit mos me i dhanë,
- 75 pse tjetër gji Mujit për me i dhanë,
 e batis²⁰ dynjanë²¹ anembanë.
 At'herë zanat Mujin po e zhgjertojnë,²²
 se sa t'vogël²³ që po flasin,
 përmbi krye hana tuj i shikue,
-

16) pak

lufton kundër kulçed-rës.

17) brez, mes

20) shemb, shkatërron, prish

18) përsëri

21) botën

19) Qënie mitologjike e përfytyruar me forcë
 të mbinatyrrshme, që

22) pyesin për të hetuar
 23) me zë të ulët

- 80 përmbas shkambit hija tuj u zgjatue,
sa miqsisht me të kanë kuvendue!...
Ferk e ferk²⁴ Muji qenka çue,
i ka gjetë lopët e në shpi ka shkue.
N'fushë t'Jutbinës Muji kur ka ra,
- 85 bytym²⁵ shokët e mbledhun i ka pa,
se me Mujin kishin qenë mësue,
me ia mujtë²⁶ Mujit tuj ladrue.²⁷
Kqyre seri²⁸ Muji çka ka ba:
ia ka nisë me çobaj me ladrue,
- 90 send ma t'fortin me dorë e ka kapë,
pesë konopë²⁹ përpjetë i ka dhanë.
Askurkush me folë nuk po flet.
Se me thue kur po i bjen,
dekun n'tokë, gjinden³⁰ po i qet.³¹
- 95 Prej zotnisë, tha, Muji asht largue,
prej zotnisë, tha, burri kur asht da,
ka dredhë n'shpi, tha, nanën për me pa,
tha, ja nis Muji tuj punue,
tha, ja nis Muji tuj luftue!
- 100 E n'sa lufta Muji si po bjen,
ai gjithherë me nder si po del.

24) shpejt, menjëherë

28) shih çudi, për t'u çudi-

25) të gjithë

tur

26) për ta mundur, për ta
vënë poshtë

29) litar, türküzë

27) duke lozur

30) njerëzit

31) këtu: hedh

— Karakterizoni figurën e heroit si njeri i zakonshëm,
me tipare e ndjenja të thella njerëzore. Ilustrojeni këtë me
vargjet përkatëse.

— Gjeni vargjet ku ka metafora, anafora dhe hiperbo-
la. Çfarë do të theksojë me anë të tyre rapsodi?

— Bëni portretin e Mujit kreshnik, të veshur me cilësi
të jashtëzakonshme, duke e ilustruar me vargjet përkatëse.

MARTESA E HALILIT

(Nikaj — Mertur)

Këngët e kreshnikëve marrin shpeshherë pikë-nisje nga kontradikta shoqërore midis bashkësive të lira fshatare dhe jetës feudale. Ato shprehin kështu qëndresën ndaj përpjekjeve të feudalëve për të depërtuar midis këtyre bashkësive, paraqesin lufta për kullota etj. Një temë që trajtohet dendur tek këto këngë, është ajo e martesave me rrëmbime vajzash nga pala kundërshtare, temë kjo që paraqet një zakon të vjetër martesash të kohërave të lashta. Një temë të tillë trajton dhe kënga e njohur «Martesa e Halilit». Më tepër se për subjektin e saj kjo këngë ka vlerë për tablotë e saj lirike, për mjeshtërinë e lartë artistike me të cilën është skalitur portreti i vajzës, bukuria dhe gjallëria e peizazhit me të cilin rapsodi ka ditur të rrethojoë zhvillimin e ngjarjeve.

Interesimin e fisit për të martuar Halilin me një vajzë të krahinës, heroi e kundërshton, sepse të gjitha vajzat e krahinës, sipas një zakoni të malësisë, ai i quan motra. Halili ja ka vënë syrin Tanushës së bukur të krajlit, të cilën e ka njohur mirë. Ky çast përbën zanafillën e një sërë ngjarjeve. Pas një dimri të egër që bën të ushtojnë lugjet prej ortiqesh, të ngrijnë ujërat dhe të mbulohen çetinat deri në kreshtat e tyre prej dëborës, vjen pranvera, shkrihen akujt dhe këndojnë bilbilat në mal. Rrugët janë hapur dhe Halili niset me gjogun e Mujit për tek Tanusha. Megjithë përpjekjet e Halilit për t'i shpëtuar syrit të babait të Tanushës, krajlit, ai diktohet, zihet rob dhe burgoset prej tij. Tanusha gjen mënyrën dhe lajmëron Mujin për çka i ka

*ndodhur Halilit. Muji së bashku me shokët i vjen
në ndihmë të vëllait. Ai arrin pikërisht në çastin
kur krajli e ka nxjerrë Halilin pér t'i prerë kokën
para popullit. Fillon këtu një luftë e përgjakshme
midis të dy palëve që përfundon me shpëtimin e
Halilit dhe të Tanushës.*

*Forca artistike që shkëlqen në përshkrimin e
bukurive të natyrës dhe të portretit të vajzës është
pasojë e frysimeve të artistit popullor prej pei-
zazhit madhështor të maleve tona dhe jetës së za-
konshme të malësorit tonë. Kënga përshkruan me
një forcë artistike të madhe ashpërsinë e malësive
tona, duke na lindur kështu mendimin se ç'njerëz
të fortë janë ata që u durojnë atyre kushteve.
Ndërsa skenat luftarake që përshkruhen në të, të
kujojnë ashpërsinë e luftërave të përgjakshme që
ndizeshin herëpashere midis fshatarësish dhe feu-
dalëve.*

- ... Fort po shndrit njaj diell e pak po nxe!
C'po e merr frima¹ rrapin e Jutbinës!²
Borë e madhe që ka ra,
randojnë ahat pér me u thye,
5 kin çetinat³ vetëm kreshtat,⁴
ushtojnë lugjet prej ortiqesh,
prej ortiqesh, kah po bijnë ndër gropat.
Kanë ra vashat me gja⁵ n'lumë,
kanë gjetë lumin tanë ngri akull;
10 kanë nisë vashat me lyp krojet,
kanë gjetë krojet tanë ngri hej!⁶ ...
Ka dalë Muji me kreshnikë,

1) erë e fuqishme

2) kryeqendra e kreshni-
këve

3) lloj pishe

4) majat

5) gjë e gjallë, bagëtia

6) shumësi i fjalës *hell*
(heje akulli, kallama
akulli)

- a thue ndeshet m'ndojo gja malit? . . .
 Sa shpejt diellin ma zu reja,
- 15 shpejt ma endi nji pélhurë t'gjanë e t'gjatë,
 e i ka veshun majat rreth e rrotull,
 që kur janë kapë trimat-o te lumi;
 kaq pérzi i ka frima plajm⁷ e re,
 askurrnja⁸ shoshojnë trimat s'po e njobin.
- 20 In ngri⁹ trimat me sharrue; ¹⁰
 por n'breg t'lumit — nulla e Mujit!
 T'tanë pér darkë Muji i ka ndalë.
 Kqyr çka bani Gjeto Basho Muji:
 e ka vu nji barrë dru t'vogël n'zjarm,
- 25 treqind vetë priherë¹¹ m'u nx...
 Sa shpejt fryma burrave u ka ardhë,
 sa shpejt gjaku trimave po u nxehet,
 Kanë marrë llafin e po llafiten,¹²
 kanë marrë gazin e po gazmojnë;
- 30 kanë nissë trimat Mujin po pyesin:
 — N'votër tande kem' qëllue,
 mos na ki randë pér nji fjalë...
 Qysh Halilin s'e martove?
 Janë martue krejt mosha e tij...
- 35 Djemt e tyre n'lojë tē tanë kanë dalë.
 A t'u dhimbten paret pér me i dhanë?
 A t'u dhimbten dasmat pér me i ba?
 Tutna¹³ djalin dikush po na rre,¹⁴

7) borë e imët

8) asnjëri

9) ishin ngrirë

10) pér tē vdekur

11) pérnjéherë

12) bisedojnë

13) kemi frikë

14) gënjen, mashton

- shpesh e shpesh po bje n'Kotorre t'Reja,¹⁵
 40 rob tē gjallë djalin po e zanë.
 Le konakun, Mujë, që po ta fikin¹⁶
 ma zi¹⁷ fisin, Mujë, po na koritin . . .¹⁸
 — Faqebardhë, more shokë, ju qofshi,
 se mirë hallin po na ditki, burra . . .
- 45 Ju t'pavllazën, shokë, s'keni qëllue;
 kujt po i dhimben dasmat pér vlla t'vet?
 Ky edhe s'asht, or burra, cub¹⁹ flligshtish,²⁰
 mirë e njihni se a daji²¹ trimnish . . .
 At'herë djali ka nis me folë:
- 50 — Kah kam vlla e kah kam motër,
 vdeksha para, n'u martosha!
 Se gjithë gratë e Krahinës, ku janë,
 se gjithë vashat e Jutbinës, ku janë,
 bash²² si motra që po m'duken.
- 55 Dheu m'ka mblue e fat s'i qita vedit,²³
 po s'e mora Tanushën e krajlit.²⁴
 E unë Tanushën vetë e kam pa,
 Kur kemi pasë besë me krajli.²⁵
 Gja ma t'mirë s'sheh njeri nën kët diell!
- 60 Vetulla e saj drejt si fiskaja,²⁶
 shtegu i ballit, si shtegu i malit,
 kur merr hana me pranue;²⁷
 syni i saj, si kokrra e qershisë,

- 15) në rapsoditë, qytet në
 breg tē detit, ku kresh-
 nikët lakmojnë shpesh
 tē bëjnë trimëritë e ty-
 re
- 16) shuanjë, shkatërrojnë
 17) më keq
 18) turpërojnë
 19) ai që bën punë tē ligë
 20) veprime tē turpshme
 21) trim

- 22) tamam
 23) vetes
 24) mbret; këtu: prijësi i
 palës kundërshtare tē
 kreshnikëve
- 25) vendi i krajlave, toka
 ku zhvillojnë kreshni-
 kët luftërat e tyre
- 26) thupér e hollë
 27) tē perëndojoë

e ka qerpikun si krahu i dallndyshës,
 65 fytyra e saj, si kuqet molla n'degë,
 hunda e drejt-o, si kalemi i Tushës,²⁸
 goja e vogël, si lulja që shpërthen,
 dhambët e bardhë, si gurëzit e lumit,
 fill²⁹ mbas shiut kur po i shndrit dielli;
 70 qafa e saj, si qafa e pllumbit,
 shtati i saj, si shtat çetine,
 misht e dorës, porsi rremi³⁰ i shemshirit . . .³¹
 Ka folë plaku Osman Aga:
 — Ditë e madhe nesër ka qëllue,
 75 tridhetë Agë kanë me u bashkue,
 tridhetë vasha t'i kanë prue.
 Njat ma t'mirën ke me e zgjedhë . . .
 S'po e len djali plakun ma me folë: . . .
 — Ndeja kuk³² si natën e vorrit,
 80 e n'Krahinë cok³³ s'u martova.
 Por n'qafë m'paçi, mori Bjeshkët e Nalta,
 kurrkund' i shteg që nuk ma latë,
 për me dalë deri n'at Krajli . . .
 Sa mirë nama³⁴ bjeshkët m'i paska gjue!³⁵
 85 Sa shpejt deti ka ndigjue!
 E e ka çue nji frimë të fortë,
 e e ka çue nji frimë të nxehthë,
 e e ka lshue krejt renë e zezë.
 Binë ortiqet nëpër gropë,
 90 ushtojnë malet si prej motit.
 Por tri ditë e ma s'ka zgjatë,

28) emër i një mjeshtri të
dëgjuar

29) menjëherë

30) dega

31) lloj druri

32) qyq, vetëm

33) patjetër

34) mallkimi

35) goditur

- a shkri bora e ka ra n'lumë;
por tri javë e ma, s'ka zgjatë.
Çka e ka ba lumi atë t'bardhë?
- 95 T'bardhët e bjeshkëve krejt e ka mbytë n'det . . .
C'po këndoijnë bilbilat n'mal!
C'po lodrojnë fmija npër fushë!
— Shpejt me dalë te tbani,³⁶
se ka shpérthye ahi!
- 100 At'herë djali Mujit i ka thanë:
— Qe tash gjogun, Mujë, ti me ma dhanë . . .
Gjogun e vet Muji ia ka dhanë . . .
At'herë djali i ka kcye gjogut n'shpinë:
— T'mirë u pafshim! — Mujit i ka thanë.
- 105 Ka marrë dromin³⁷ për krajli,
dy herë djalin kurrikush s'e ka pa.
Kalojnë male e kalojnë lugje,³⁸
kalojnë breshtë³⁹ e kalojnë ashtë,⁴⁰
kalojnë ditë e kalojnë net . . .
- 110 — Ç'a ka hana që s'po del?
Kanë pyetë bilbilat malit.
— Pritni pak, more zogjt e malit,
ju me kndue, tjetër punë s'keni.
Hana sonte ka ndodhë zanë,
- 115 ka nji ndore⁴¹ me përcjellë! . . .
Qat'herë djali sa kish ra n'breg t'lumit,
ka lidhë gjogun mbrendë n'nji imshtë,⁴²
imshta ishte tanë ahishtë.
Vetë shatorret⁴³ npër muzug t'natës po i lyp.⁴⁴

36) stani në bjeshkë

37) rrugë e madhe

38) lugina

39) pyll me bredha

40) ahishte, pyll me aha

41) në dorë, në kujdes, në

mbrojtje

42) ahishtë me drurë të rinj

43) tendë, çadër

44) kërkon

- 120 Kur ka mbrrijtë te çadra e kuqe,
qat'herë djali por ka ngulë,⁴⁵
ka zanë vend përmbas nji lisi,
rrajët e lisit shpérnda në lumë ...
Sa urtisht djali që po e msyn:⁴⁶
- 125 ma kan nxjerrë thikën ma t'mprehtën,
kamba-doras asht avitë ...
— Po kët ftyrë ku e kam pa,
që po m'ngjet me t'Halilit?
Tjetër⁴⁷ djali s'asht durue ...
- 130 — Po a je njeri që ke besë?
— T'thafshin krahët, more djalë i ri,
se fort thellë që paske hy! ...
Hajde mbrendë, kopil⁴⁸ — po i thotë, —
se ja vdesim të dy priherë,
- 135 ja kem'pshtue⁴⁹ të dy priherë ...
At'herë djali mbrendë ka hy.
E ka marrë vasha pér dore,
shpejt e shpejt te nji odë i prin ...
I kanë zgjedhë 'i palë petka⁵⁰ ma t'mirat ...
- 140 Krejt si cikë⁵¹ djali po ngjan ...
N'breg të detit, përmbi 'i shkamb,
dymdhetë katesh nulla e naltë,
kurrkund shoqen nuk e kishte;
treqind hapash nulla e gjanë,
- 145 t'tana ballet guri t'lmue,
anash krejt guri t'latue,⁵²
latue shkambi prej mermeri.

45) èshtë ndalur, èshtë ngu-
lur

46) sulmon

47) më shumë

48) djalë i shkathët

49) shpëtar

50) rroba

51) vajzë

52) të gdhendur, të skalitur

- Aty gurrat me u flladitë,
 aty kopshti me u mahitë,⁵³
 150 aty velat me velzue,⁵⁴
 me velzue pér shpinë të detit . . .
 Me Halilin mbrendë kanë hi! . . .
 Sa fort shpejt krajlica gadi a ba! . . .
 Kur ka pa sokol Halilin,
 155 a dredhë mbrapsht, si dredhet gjarpni . . .
 Edhe derën e ka shkrepë,⁵⁵
 fill⁵⁶ te krajli paska shkue . . .
 — T'kanë ardhë cubat e Jutbinës
 e ty kullat t'i kanë zaptue,
 160 erzin⁵⁷ marrë, qikat shnjerzue!⁵⁸ . . .
 Krajli shpejt qenka shtërngue, . . .
 t'dy pér krahu krajli i ka kapun . . .
 N'burgje t'thella Halilin e ka ndry,⁵⁹
 rrugën e madhe Tanushës ja ka dhanë . . .
 165 Mirë po e ndal Jovani⁶⁰ e po e pyet:
 — Ç'a kta vaj, Tanushë, lum motra?! — i thotë
 Se kso britme kurrë nuk kemi ndi! . . .
 — Rob kanë zanë Halilin e Mujit
 e mue rrugat tata⁶¹ m'i ka dhanë,
 170 ma pér t'gjallë te shpia mos me kthye! . . .
 Nji fjalë⁶² Mujit te dera me ia çue:
 që me i ra mbrapa Halilit sa ma parë,
 ndryshe djali n'burgje t'u ka kalbë . . .
 E ka gjet nji njeri bese,

53) të tallesh, të kalosh ko-
hën

54) të lundrosh

55) hapur me forcë

56) drejt

57) nderin

58) turpëruar

59) mbyllur, burgosur

60) Emër i një miku

61) babai

62) lajm

- 175 menjiherë Mujit natën ia ka nisun.
N'nesret nadje djali a kapë⁶³ te nulla,
nji ka nji punët ia kallzon Mujit.
T'madhe⁶⁴ burri paska nisë me qeshë:
— A t'kam thanë, taraku⁶⁵ i Kotorrit,
- 180 se Kotorret kanë me ta hangër kryet? ...
A dalë trimi në beden⁶⁶ të kullës,
me nji kushtrim ka thirrë Jutbinë e Krahinë ...
— S'kam çka u them, more agët e mi,
veç m'koriti sokol Halili!
- 185 E kanë zanë mbrendë në Kotorre t'Reja ...
Me u shtërngue, burra, si t'mundi,
se dita e vdekës ma e vështirë ndryshe nuk
vjen! ...
Kanë ba ashtat trimat me ushtue,
kanë ba lumin trimat m'u turbullue.
- 190 kanë ba gjogat trimat me flurue
e t'janë kapë te Kotorret e Reja ...
Npër ranë t'detit Muji i ka shpërnda.
— Vër me gojë⁶⁷ mos guxo kush me ba! ...
Se shumë njeri qenka mbledhë,
- 195 ndër ato Kotorre t'Reja!
Me kushtrim krajli i ka thirrë ...
N'mjedis⁶⁸ t'logut⁶⁹ nji djale i ri,
hekrat duersh, bugagité⁷⁰ kambësh.
Ai asht Halil aga i zi,

63) ka mbrritur

64) me zë të madh, të lar-
të

65) mkat, ka

66) pjesa e sipërmë e ku-
llës

67) fjalë, zë, zhurmë

68) në mes

69) shesh, vend i caktuar
për dyluftime, argëtime
popullore etj.

70) prangat

- 200 mbarë Kotorret me atë po qeshin ...
 — A po e sheh, Halil, vdekën me sy?
 Kurr⁷¹ ma ngushtë, Halil, a thue ka qenë?
 Kuvend burrash djali paska shtrue ...
 — S'a ngushtë njeri deri n'ditë të vdekës! ...
 205 — Fjalm e mbrapme, n'e paç, për me folë,
 se tyjeta m'njat⁷² hu t'u ka sosë! ...⁷³
 — Pesë dekika⁷⁴ liri për me m'dhanë.
 Tjetër t'mirë ne t'parët nuk na kanë lanë,
 kurrnji nesh mos me vdekë në t'shtrueme,⁷⁵
 210 por me shpata m'u pre tuj këndue ...
 Edhe duert mirë ia shpengojnë,⁷⁶
 ia kanë dhanë lahitën⁷⁷ n'dorë.
 Kurrikush djalin vesht s'mund e ka marrë.
 Krejt po e kndon kangën n'gjuhë të parve ...
 215 Qaty Muji përfushë ka dalë
 e e ka ba nji piskamë⁷⁸ t'madhe,
 janë shembë kullat gjer n'themele!
 E t'a trandun⁷⁹ deti me hy mbrendë,
 kanë gjëmues malet si për mot t'lig,
 220 kurrnji trimat nuk po e lanë me ikë.
 Luftë e rreptë aty që po bahet,
 me dhambë trimat duen shoshojnë me shkye;
 me dhambë gjogat duen shoshojnë me marrë;
 notojnë kurmat⁸⁰ thellë në det,
 225 notojnë trupat nëpër gjak;
-

71) ndonjëherë

re me të cilën shoqërohen këngët e kreshnikëve

72) në atë

78) britmë e madhe, sokë-

73) mbaruar, marrë fund

llimë

74) minuta

79) trembur

75) shtresa, rroba fjetjeje

80) trupat, kufomat

76) çlirojnë, zgjidhin

77) vegël muzikore popullo-

- hiç s'po lodhet Gjeto Basho Muji,
 sa thellë trimi m'paska hy!...
 Muji djalin e ka shpengue.
 A turrë djali si i tērbue,
 230 gjallë me dorë krajlin ka zanë,
 me shpinë n'hu ditët i mbaroi.
 Qatherë burrat kanë rrokë unat;⁸¹
 shpejt qyteti ka marrë zjarr,
 ka marrë zjarr krejt n'fund e n'majë.
 235 Sa fort Muji m'asht tērbue!
 Aspak dhimbë trimi s'po ka,
 as pér nulla.që rrrenohen,
 as pér t'vdekun që shkrumbohen!...
 tri herë dielli ka pranue,
 240 tri herë hana ka ague,
 kurkund, zjarri me pushue ...

81) dru zjarri tē ndezura,
 urët

— *Vini re se me ç'forcë tē madhe artistike e ka pér-shkruar dimrin e Alpeve tonas rapsodi. Gjeni vargjet që kri-jojnë këtë peizazh dhe ç'figura letrare ka përdorur.*

— *Gjeni paralelizmat figurative dhe thoni se me ç'gjen-dje shpirtërore tē heroit lidhen.*

— *Të vihet re kalimi në përshkrimin e shpejtë dhe tē bukur nga dimri i ashpër në pranverën e shumëpritur. Gje-ni vargjet që e japid këtë tablo tē gjallë tē natyrës.*

— *Vini në dukje se çdo tē thotë rapsodi me antitezën e goditur tē vargut tē parë.*

— *Tregoni se me ç'figura letrare paraqitet portreti i Tanushës. Ilustrojeni me vargjet përkatëse.*

— *Gjeni vargjet ku janë përdorur hiperbola.*

MUJI TE MBRETI

(Dukagjin)

Në këtë këngë është trajtuar një subjekt me vlerë shoqërore. Të dy kreshnikët, Muji dhe Halili, i janë kundërvënë mbretit, përfaqësuesit më tipik të shtypësit dhe të dhunës shoqërore të kohës. Të dy vëllezërët kanë kryer shumë vepra trimërie. Dikush prej kundërshtarëve ka shkuar te mbreti dhe është ankuar kundër tyre. Mbreti i ka thirrur në Stamboll që t'i qortojë. Ata bisedojnë me të emën dhe ajo i këshillon të venë. Shkallët e pallatit thyhen kur ngjiten kreshnikët. Mbreti i sheh, tmerrohet prej forcës së tyre, prandaj u tregohet si mik i përzemërt. Duke dalë andej ndodh një skenë për të qeshur: Kopsa e tirqëve të Mujit ngatërrrohet tek fijet e leshta të postës ku është ulur mbreti dhe Muji del jasht duke e tërhequr atë zvarrë.

Kënga krijon një efekt komik të goditur. Menjëherë bie në sy dëshira e popullit për të vënë në lojë mbretin. Kjo arrihet duke krijuar kontrastin midis trupit si xhuxh të mbretit dhe shtateve vigate të Mujit e të Halilit. Në këngë përshkruhet forca e rrallë fizike e kreshnikëve në ecje e sipër. Nga vrapit i tyre merr flakë pylli dhe bjeshka mbulohet me tym. Kurse mbreti nuk është gjë tjeter, veçse një figurë e dobët, e pafuqishme dhe qesharake përpara tyre. Edhe këtë këngë e përshkon veç talljes së hollë ndaj mbretit edhe besimi te forca e njerëzve të popullit që i përlau mbretërit.

Djem të mirë Muji me Halilin,
trima zollumqarë! ¹

As s'kanë lanë drum ² për ta thye, ³
as s'kanë lanë baloz ⁴ n'mejdan ⁵...

5 Davë ⁶ kanë ba raja ⁷ e Stambolli
e përpara mbretit te i kanë ra:
— Ti që je mbret e baba i t'gjith' dynjasë,
sundon dynjanë anembanë,
ja sundo edhe Mujin e Halilin,

10 ja kso toke neve po na heqin!
E ka shkrue mbreti nji letër t'hollë,
ia ka dhanë tartarit ⁸ në dorë
e po ia çon Mujit e Halilit.

E merr Muji letrën po e këndon;
15 toje-toje ⁹ vetullat n'ballë janë dredhë ...
— Ne po shkojmë e nanën po e pyesim,
si t'na thotë nana po bajmë!

E kanë shkue te nana dhe e kan' pyet,
nana djemve mirë u ka përgjegj: ...

20 — Mirë shtërngohi e gjogat mirë me i shlue, ¹⁰
hajtni, loke, ¹¹ te mbreti t'ju presi!
Kur ka nisun drita e bardhë me dalë,
po i shtërngojnë djemt gjogat mir' e mirë,
e i kanë vue gunat në krye,

1) prishës, shkatërrues

2) rrugë e madhe

3) prish

4) trim i tërbuar që vjen
nga deti për të marrë
haraçë, taksa, etj.

5) shesh dyluftimi

6) padije, ankim në gjyqj
etj.

7) popullsia jo myslimanë

që jetonte brenda kufij-
ve të Perandorisë Turke.

8) njeri i fortë që shpie let-
rat, postjer

9) togje-togje

10) shaluar, t'i bëjnë gati
për udhë

11) fjalë në Malësi të Ve-
riut me të cilën thirret
nëna përkëdhelje.

- 25 e u kanë dhanë mustakëve për teposhtë ;
 me zinxhirë lidhë gjogat, po u shkjepojnë ¹² . . .
 Por po i zanë gunat nën shtat
 e u kanë dhanë mustakëve fill përpjetë,
 tym e mjegull gjogat i kanë ba,
- 30 flakë të verdhë përzi me shkumë po qesin,
 dushku i malit marrë flakë, që po derdhet,
 kurrikund bjeshkët prej tymit, nuk po shihen.
 Djemt ¹³ e mbretit kqyr se çka kanë thanë:
 — Ç'janë kto bumurime ¹⁴, që po bumrojnë?
- 35 A mos janë topa n'Krajli? . . .
 — Nuk janë, jon kto bumrimë për qiell,
 as nuk janë gjamë ¹⁵ luftash në Krajli,
 por janë kah vinë Muji e Halili!
 E n'derë të mbretit Muji paska ra.
- 40 Kur a kapë për shkallë përpjetë me hipë,
 shkallët e mbretit Mujin s'mund e kanë mbajtë,
 shpejt e shpejt mjeshtrit m'ta ¹⁶ i ka pru,
 qaq ma shpejt ¹⁷ shkallën e ka ndreqë.
 Kur kanë vajtë në derë kesh-e ¹⁸ me hy,
- 45 dera e mbretit Mujin s'e ka zanë,
 qaq ma shpejt derën e ka goditë . . .
 — Nam, ¹⁹ të madh për ju, djem, që kam ndie,
 m'ka marrë malli që me ardhë m'u pa!
 Se sa pak Muji ka ndejë,
- 50 — Izen, ²⁰ mbret, se due m'u çue!
 Kamcen, ²¹ n'post ²² Muji e paska mbërthye,

12) çalojnë

19) famë, emër

13) ushtarët

20) leje

14) bubullimë, gjënim

21) kopsa e tirqeve

15) zhurmë, jehonë

22) postë, postiqe, lëkurë

16) në të, tek shkallët

kafshësh për shtresë,

17) po aq shpejt

më shpesh lëkurë

18) kinse: këtu: për të hyrë

dhensh.

kur ka ba trimi m'u çue në kambë,
zhag²³ te dera mbretin e paska qitë!

23) zvarrë, rrëshqanë

— Të vihen re trajtat hiperbolike me të cilat janë vizatuar dy heronjt e këngës; ilustrojini këto me vargjet përkatëse.

— C'tregohet me detalin artistik të prishjes së shkallëve dhe të derës së mbretit, kur hyjnë kreshnikët?

— Përfytyroni skenën e fundit të këngës. Nëpërmjet vënies në lojë të mbretit, shprehet ideja e rëndësishme e luftës klasore, e urrejtjes që njerëzit e thjeshtë ushqenin kundër klasave shfrytëzuese.

— Thoni çfarë do të shprehë rapsodi me vargjet: «Ne po shkojmë e nanën po e pyesim. Si t'na thotë nana po bajmë»?

AJKUNA QAN OMERIN

(Curraj i Epër)

«Cikli i kreshnikëve» ka karakter epik-heroik. Megjithatë, aty-këtu, gjemjë vargje të tëra ku shpërthejnë me forcë ndjenjat e vrullshme të pullit. «Ajkuna qan Omerin» është vajtimi që e shoqja e Mujit i bën të birit 7-vjeçar. Omeri ka mbetur në luftë dhe i ati e varros në Lugje të Verdha. Si djalë i një babai me veti të mbinatyrshme ai dallohej për guximin dhe aftësitë e tij të jashtë-zakonshme.

Ajkuna — nënë qan dhe vaji i saj i dhembshëm trondit si qeniet e gjalla ashtu edhe objektet e personifikuara me mjeshtëri nga rapsodi. Ai vajtim ka forcë të madhe prekëse. Përmes fjalëve poetike skalitet bota e brendshme shpirtërore e nënës, dashuria dhe gadishmëria që të sakrifikohet për të birin.

Peizazhi ndërthuret me gjallëri dhe krijon efekte të fuqishme emocionale. Me mjeshtëri të rrallë janë përdorur paralelizmat figurative dhe figura të tjera letrare.

Në fund të vajtimit të saj dëgjuesi krijon të plotë figurën e Ajkunës: një nënë e zakonshme, tokësore, me një pasuri të pafundme ndjenjash njerezore, por e detyruar të mos përfillet nga burri dhe t'i nënshtrohet atij gjithmonë. Në figurën e saj është dhënë e përgjithësuar gjendja e gruas që s'kishte të drejtat më elementare, bile edhe atë si nënë.

... Drita e dalë¹ e dritë s'po ban,
 ka le dielli e nuk po nxe.
 Ça ka ba Gjeto Basho Muji: ...
 Djalin n'dhe Muji e ka shti,
 5 kurrkush ngjat² nuk ka qëllue.
 Muji vorrin tue e rrmue,³
 veçse zanat tue lotue,
 veçse shokët që po e gjamojnë,⁴
 veçse gurët që po e mbulojnë,
 10 edhe ahat, që e rrethojnë,
 mirë bilbilat djalin po e vajtojnë.
 A dredhë Muji e n'shpi ka shkue;
 nana e djalit po e pyet:
 — Mujo, djalin ç'ma ka gjetë,
 15 n'Lugje t'Verdha, a thue, ka mbetë? ...
 Aman, Mujo, djalin ç'ma ke ba?
 At'herë trimi ka qitë e i ka thanë:
 — Me e vajtue kur t'shkojsh për dru,
 zhurmë n'konak nuk due me m'ba ...
 20 N'Lugje t'Verdha, n'daç me e pa,
 Aty djalin n'dhe ta kena shti.
 — Qyqja, nana e padjalë!
 Ka nisë grueja me bërtitë.
 Sa shpejt jashta Muji e paska qitë.
 25 Qyqe vetëm rrugën ma paska marrë,
 kanë zanë vend yjt vajin për me e ndie!⁵
 Kur ka dalë ndër Lugje t'Verdha,
 at'herë hanën nana ka mallkue:
 — T'u shkimtë⁶ drita ty, o mori hanë,

1) ka dalë, ka zbardhur

4) vajtojnë, qajnë me brit-

2) pranë

ma

3) duke gërmuar

5) ta dëgjojnë

6) t'u shoftë!

- 30 që s'ma çove at'natë nji fjalë,
 n'Lugje t'Verdha shpejt me dalë,
 bashkë me hy n'nji vorr me djalë!
 Ndoshta vorri t'dyve s'na kish zanë,
 ndoshta djali ngjat nuk m'kishte lanë,
 35 nji vorr t'ri, por kishe çel përbri,
 abit t'malit rixha ⁷ i kisha ba,
 gurit t'malit rixha i kisha ba,
 rrahit ⁸ t'zi ndër kambë i kishe ra;
 ka qëllue bjeshka e gjanë,
 40 gjithkund t'dueni vend me zanë,
 por mue gropën me ma lanë,
 sa aq vend ma kishin falë.
 Mallkue qofsh, o mori harë,
 qysh me e lanë nanën t'padjalë!
 45 Kur ka shkue te vorri i djalit,
 ka pa ahin treqind vjeç,
 ahi ishte rrema-rrema,
 nji ma t'bukrin ⁹ mbi vorr që po e shtrin,
 Mirë po pshtetet për degë t'ahit,
 50 pikon loti mbi vorr t'djalit.
 Kanë lanë kangën zogjt' e malit,
 kanë lanë kangën me vështrue!
 — Po a s'e din se kush ka ardhë,
 që nuk çohesh për m'u falë, ¹⁰
 55 more i miri i nanës-o?
 Amanet, o more bir,
 dil nji herë ksi burgut t'errët,
 fol me nanën që t'ka rritë,

7) lutje

8) tokë e shpyllëzuar dhe e punuar

9) degën më të bukur

10) për t'u përshëndetur

- s'm'ke lanë kurr' kaq shum' me pritë!
 60 Ka lshue hana rrezet n'pyll,
 kanë shkrepë yjxit nëpër qiel,
 pyesin diellin: — A e ke pa?
 — Nuk po m'len nji ah me e pa.
 — Amanet pse i le m'u djerrë? ¹¹
 65 — Thuej m'kanë mblue me dhe të zi,
 drita e juej mbrendë mos me hy,
 vaji i nanës o mos me u ndie,
 loti i nanës o veç me m'mbrri.
 — Mor Omeri i nanës-o!
 72 A thue gjogun me ta pru;
 dil ndojherë pér me lodrue,
 bjer ndër gurra me u freskue,
 kérko majat bashkë me zana,
 se ty vorrin ta ruen nana,
 75 more i miri i nanës-o!
 Orët e bjeshkës ma s'mund po e ndiejnë,
 fjalën n'gojë po ja kthejnë dalë, ¹²
 zemrën s'rrahmi ja kanë ndalë,
 lotët ndër sy mirë po ja krijnë, ¹³
 80 ftyrën lotsh mirë po ja fshijnë,
 vet' e bajnë ¹⁴ e e çojnë n'Jutbinë.

11) të humbë, të mos gjejë

13) ngrijnë

12) mbrapsht; këtu: presin,
ndalin

14) mbartin, transportojnë

- Gjeni në këtë këngë vargjet më të bukura që janë
 vënë në gojën e nënës dhe thoni çfarë shprehët përmes tyre.
 — Gjeni në tekst vargjet që flasin pér pozitën e nën-
 shtruar të gruas.
 — Gjeni paralelizmat figurativë.
 — Gjeni dhe analizoni personifikimet, metaforat dhe
 antezat e këngës.